



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51 regjistër (JR)
Datë 09.12.2022

Nr. 53 i vendimit
Datë 15.12.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 15.12.2023, ditën e premte, në orën 09:15, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me sekretare gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 51/2022 (JR), datë 09.12.2022, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 574, datë 18.10.2022 dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi, shqyrtoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;* (ii) *nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e pasurive;* (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;* (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;* si dhe (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
 - 2.2. DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin nr. {***} prot., datë 02.11.2017, mbi kontrollin e figurës, të përditësuar dhe deklasifikuar pjesërisht ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi. Në datën 12.05.2022, me shkresën nr. {***} prot., DSIK-ja ka dërguar një raport të dytë të përditësuar, sipas së cilit grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë nga

përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi.

2.3. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 574, datë 18.10.2022, lidhur me të tri kriteret e rivlerësimit, në vlerësimin tërësor të çështjes, për subjektin e rivlerësimit Pëllumb Zaimi, ka konkluduar se:
 - a. *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*
 - b. *Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*
 - c. *Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.*
4. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni vendosi: *“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”*.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, në datën 25.11.2022, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi, bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
6. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se nga shqyrtimi i vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla faktike e ligjore, të cilat e bëjnë atë të

cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'ia paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

7. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisionerit Publik, rezulton se çështjet e ngritura prej tij adresohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale e të kriterit të pasurisë, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1. Lidhur me gjetjet në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas Komisionerit Publik, nga çështjet gjyqësore të analizuara për shkak të denoncimeve të paraqitura në Komision, ndër të tjera, janë evidentuar rrethana në të cilat duket se subjekti ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit. Konkretisht, në denoncimin e tij drejtuar Komisionit shtetasi A. D. ka pretenduar për vendimmarrje të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procesin gjyqësor për një konflikt pronësie për pasurinë që ai trashëgon ndër vite. Denoncuesi e lidh vendimmarrjen edhe me pozitën e vajzës së subjektit të rivlerësimit, si drejtuese e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Berat, pasi konflikti gjyqësor ka si person të tretë edhe këtë institucion, i cili, sipas padisë, kërkohej që, ndër të tjera, të bënte edhe regjistrimin e një sipërfaqeje toke. Denoncuesi pretendon se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për mospranimin e padisë së tij është e ndikuar nga ankesa që ka bërë në AShK, pasi, kur nga përfaqësuesja e tij në seancë gjyqësore është kërkuar që t'i merret informacion AShK-së, subjekti i rivlerësimit ka orientuar që kërkitimi të bëhet në portalin *e-albania*. Ndërsa shtetasi K. L., i përfaqësuar me prokurë nga shtetasi R. N., ndër të tjera, në denoncimin drejtuar Komisionit, bën me dije se në mënyrë të ripërsëritur ka bërë kërkesë për përjashtim të subjektit të rivlerësimit nga zhvillimi i procesit gjyqësor të iniciuar prej tij me cilësinë e paditësit, me palë të paditur Bashkia Berat, AShK Berat dhe shoqëria ndërtimore “{***}” ShPK, me objekt: “Pushim cenim pronësie dhe kallëzim i një punimi të ri”. Denoncuesi pretendon për gjendje të konfliktit të interesit në këtë çështje pronësore, me subjektin e rivlerësimit, për shkak se praktika e AShK-së Berat në adresë të tij është nënshkruar nga vajza e subjektit, si titullare e këtij institucioni. Sipas Komisionerit Publik, rastet e evidentuara më lart pasqyrojnë mungesën e kujdesit të pritshëm të subjektit të rivlerësimit, për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, qoftë dhe në dukje, në vlerësim të zbatimit të pikës 6, të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, e cila parashikon rastin se gjyqtari detyrohet të dorëhiqet në rast se ekzistojnë arsye serioze njëanshmërie. Në këto rrethana, Komisioneri Publik arrin në përfundimin se këto situata duhen trajtuar e konsideruar brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 96/2026), duke u vlerësuar në tërësi, në mënyrë kumulative, me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kriteve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.

7.2. Komisioneri Publik parashtron në ankim se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, zotërojnë aksione pranë shoqërisë “{***}” ShA dhe rezulton e provuar nga

shqyrtimi dhe finalizimi prej subjektit të rivlerësimit i rreth 15 çështjeve gjyqësore, me palë paditëse shoqërinë “{***}” ShA se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 72, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, dhe duhet të paraqiste kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, sipas nenit 73 të po këtij Kodi.

7.3. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, në trajtimin e çështjeve si vijon:

7.3.1. Në vendimin penal nr. {*}, datë 10.12.2019,** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për procedimin penal nr. {***}, datë 31.10.2018, ndaj shtetasit S. T., Komisioneri parashtron se nuk qëndron disponimi nga gjyqtari se *i pandehuri është dënuar me vendim të formës së prerë për të njëjtën vepër penale*. Komisioneri Publik konstaton se, për sa kohë kjo çështje është trajtuar nga Komisioni në kuadër të të dhënave të administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e pasurisë dhe të aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

7.3.2. Në vendimin penal nr. {*}, datë 26.12.2013,** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për shtetasin K. S., Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit duhet të tregonte kujdesin e nevojshëm, bazuar në kërkesat e paragrafit 1, të nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, duke administruar në cilësinë e provës aktin përkatës/vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasit K. S., lëshuar nga organi i përcaktuar në nenin 484 të Kodit të Procedurës Penale.

7.3.3. Lidhur me denoncimin e shtetasit B. M., Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, vlerëson se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në komunikimin mes tij dhe palëve ndërgjyqëse, në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, përbëjnë sjellje që nuk i shërben këtij qëllimi. Sikundër konstaton dhe Komisioni, verifikohet se subjekti ka përdorur shprehje joetike për figurën e magjistratit, të tilla që cenojnë parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore (parimin e Integritetit, Sjelljes së hijshme dhe Vetëpërmbytjes, Respektit dhe Aftësisë për të dëgjuar etj.), duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 75, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016, dhe duhen vlerësuar nga Kolegji në tërësi, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.3.4. Lidhur me denoncimin e shtetasit B. T., Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se nga të dhënat e administruara nga denoncimi konstatohen problematika në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të cilat

duhen evidentuar dhe çmuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. *Së pari*, Komisioneri Publik vlerëson se fakti që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është ligjëruar nga gjykata më e lartë nuk mund të jetë kriteri matës i vetëm përcaktues për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për më tepër kur lidhet me aspekte të respektimit të ligjit procedural, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji në jurisprudencën e tij. Qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta nuk duhen përdorur për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët. *Së dyti*, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vendimin penal nr. {***}, datë 25.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka disponuar duke shpallur fajtorë shtetas, të cilët më parë, për të njëjtën vepër penale, për të njëjtin konflikt, mbi të njëjtat prova shkresore, kanë qenë palë akuzuese dhe, me vendim gjykate, kanë provuar se kanë qenë të dëmtuar nga personi/kërkuesi. Në përfundim, për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik, nisur dhe nga argumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, vlerëson se ka elemente për t'u vlerësuar në drejtim të indikatorit të aspektit të njohurive ligjore, referuar nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, konkretisht mbi interpretimin e parimeve ligjore, që rregullojnë institutin e sigurisë juridike.

7.3.5. Për denoncimin e shtetasit A. S., referuar të dhënave të çështjes penale nr. {***}, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi vendimi i ndërmjetëm i datës 11.02.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku një nga anëtarët është subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 27.04.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga të dhëna të marra nga burime të hapura të informacionit, rezulton të jetë prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr. {***}, datë 13.10.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 27.4.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

7.4. Lidhur me gjetjet në kontrollin e pasurisë, Komisioneri Publik parashtron në ankim se:

7.4.1. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 86 m², ndodhur në {***}, Tiranë*, në ndryshim nga Komisioni, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhen përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së/INSTAT dhe jurisprudencës së Kolegjit, të cilat në total për familjen e subjektit, për vitin 2007, llogariten në vlerën 943.872 lekë, çka afekton analizën financiare të vitit 2007, duke çuar në një mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 215.826 lekë. Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se këto pamjaftueshmëri të konstatuara, lidhur me kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi të pasurisë *apartament banimi, me sipërfaqe 86 m²*, ndodhur në {***}, Tiranë, nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por në tërësinë e vlerësimit të fakteve të konstatuara dhe të trajtuara në këtë ankim, duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 të këtij ligji.

7.4.2. Për pasurinë apartament 1+1, ndodhur në lagjen “{***}”, Berat, në kushtet kur: (i) deklarimi në deklaratën *vetting* për këtë pasuri në përdorim konstatohet i mangët; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë banuar në këtë apartament për rreth 10 vite; (iii) aktet e administruara lidhur me këtë pasuri janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, pas konstatimeve të Komisionit; (iv) këto akte paraqesin të dhëna kontradiktore ndërmjet tyre, lidhur me të drejtat reale të pronësisë/posedimit, Komisioneri Publik vlerëson se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar këtë pasuri dhe këto rrethana të padeklaruara nga subjekti dhe në deklaratën *vetting*, duhen analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

8. Në përfundim, Komisioneri Publik ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.*

IV. Apeli kundërshtues i subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegji, aktin e titulluar “Apel kundërshtues”, regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 07.12.2022¹, në të cilin ka prapësuar lidhur me ankimin e ushtruar nga Komisioneri Publik, për sa i përket etikës dhe profesionalizimit, si dhe lidhur me gjetjet në kontrollin e pasurisë. Në mënyrë të përmbledhur në këtë apel kundërshtues, subjekti i rivlerësimit parashtron:

9.1. Për denoncimin e shtetasit A. D., denoncuesi ka qenë pala paditëse, ndërsa AShK-ja Berat ka qenë person i tretë dhe nuk ka marrë pjesë në gjykim, pa ndonjë shkak ligjor, si dhe gjykimi është zhvilluar në mungesë të saj. Në referim të nenit 195/1 të Kodit të Procedurës Civile, personi i tretë ka të drejtë të kryejë gjithë veprimet procedurale, përveç atyre që kanë të bëjnë me disponim të objektit të padisë. Denoncuesi gjatë seancave gjyqësore nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me konfliktin e interesit të gjyqtarit të çështjes, megjithëse ka qenë në dijeni se vajza e gjyqtarit ishte drejtore e AShK-së Berat. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet e nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile, pasi, sipas rrethanave konkrete të çështjes, nuk kanë ekzistuar arsye serioze njëanshmërie.

9.2. Për denoncimin e shtetasit K. L. përgjigjet kanë qenë shteruese para Komisionit dhe pretendimet e denoncuesit janë verifikuar edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), që në përfundim të hetimit administrativ ka vendosur arkivimin e ankesës.

¹ Përcjellë Komisionerit Publik dhe ONM-së me shkresën nr. {***} prot., datë 12.12.2022.

9.3. Lidhur me aksionet e “{***}” ShA , ankimi i Komisionerit Publik është i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i bonove të privatizimit ka ardhur për shkak se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur asnjë interes apo përfitim nga depozitimi i tyre në Degën e Thesarit Skrapar. Ndërsa në deklaratat periodike vjetore është bërë deklarimi i bonove të privatizimit. Sa u takon çështjeve gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 11 çështje civile me palë paditëse “{***}” ShA , ku për 7 çështje është vendosur pranimi i padisë dhe për 4 çështje është vendosur pushimi.

9.4. **Vendimi penal nr. {***}, datë 10.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat**, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik është i bazuar në ligj dhe në prova dhe në dhënien e tij nuk ka mangësi profesionale dhe të njohurive ligjore. Kallëzuesi/viktima, që ka qenë prezent në gjykimin e kërkesës penale nr. {***}, nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 10.12.2019, çka tregon se ka qenë dakord më vendimin e gjykatës.

9.5. Lidhur me **vendimin penal nr. {***}, datë 26.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat**, për shtetasin K. S., subjekti parashtron se ky vendim është dhënë lidhur me kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, me objekt “Vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal”. Sipas subjektit në gjykimin e këtyre kërkesave, provat dhe aktet në seancë gjyqësore i paraqesin palët, prokurori dhe i arrestuari/mbrojtësi i tij, dhe nuk është detyrë e gjykatës në këtë lloj gjykimi të marrë vetë akte dhe prova. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 484 të Kodit të Procedurës Penale, vërtetimin e gjendjes gjyqësore në këtë gjykim duhet ta paraqisnin palët. Nga aktet dhe provat e paraqitura nga prokurori të shqyrtuara dhe administruara në seancë gjyqësore ka rezultuar se shtetasi K. S. nuk rezulton i dënuar më parë dhe ky fakt është pasur parasysh nga gjykata në dhënien e vendimit përfundimtar.

9.6. Lidhur me **denoncimin e shtetasit B. M.**, subjekti kundërshton pretendimin e Komisionerit Publik se gjuha e përdorur në komunikimin mes tij dhe palëve ndërgjyqëse përbën sjellje që nuk i shërben qëllimit të rikthimit të besimit të publikut te drejtësia. Sipas subjektit, denoncuesi nuk ka qenë palë ndërgjyqëse siç pretendon Komisioneri, por është lejuar në sallën e gjyqit të marrë pjesë si dëgjues, ndërkohë që ka kryer veprime me të cilat ka prishur rregullin dhe qetësinë e seancës gjyqësore.

9.7. **Për denoncimin e shtetasit B. T.**, subjekti i rivlerësimit parashtron se kemi të bëjmë me dy kërkesa penale/gjykime të ndryshme, të cilat janë gjykuar nga gjykata me trupa gjykuese të ndryshme. Provat e administruara dhe shqyrtuara në kërkesën penale nr. {***} dhe në kërkesën penale nr. {***} nuk kanë qenë të njëjta, kurse konflikti midis palëve ka ndodhur në datën 08.05.2019, me shtrirje në kohë. Ata janë zënë dhe konfliktuar brenda ditës dy herë me njëri-tjetrin, në vende të ndryshme. Në arsyetimin e vendimit penal nr. {***}, datë 25.10.2021, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për kërkesën penale nr. {***}, ka rezultuar e provuar se të akuzuarit B. T. dhe N. T. nuk kanë paraqitur asnjë provë në gjykim për të vërtetuar pafajësinë e tyre, përkundrazi, nga provat e paraqitura nga viktima, ka rezultuar se këta shtetas kanë kryer

kundërvajtjen penale dhe në përfundim të gjykimit janë deklaruar fajtorë. Vendimi penal nr. {***}, datë 25.10.2021, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

9.8. Për denoncimin e shtetasit A. S., subjekti prapëson konstatimet e Komisionerit Publik, duke parashtruar se vendimi nr. {***}, datë 13.10.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ka konstatuar mangësi dhe ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe jo vendimin e gjykatës së shkallës së parë në trupin gjykues të të cilit ka qenë anëtar subjekti i rivlerësimit. Vendimi i ndërmjetëm i datës 11.02.2022 ka mbetur ende në fuqi dhe pa u cenuar nga një gjykatë më e lartë, që tregon se ky vendim ka qenë i bazuar në ligj dhe në prova.

9.9. Për pasurinë *apartament me sipërfaqe 86 m²*, ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimi parashtron se janë të pabazuara në ligj dhe nuk duhet të merren në konsideratë nga Kolegji pretendimet e Komisionerit Publik të shprehura në ankim se balanca financiare e vitit 2007 afektohet me vlerën (-) 215.826 lekë, pasi shpenzimet e jetesës duhet të llogariten me vlerën 943.972 lekë. Subjekti parashtron se nuk e kupton ku e ka bazuar Komisioneri Publik gjetjen e kësaj vlere për shpenzime jetese, kur në vitin 2006 shpenzimet për jetesë kanë qenë në vlerën 438.228 lekë, aq sa i ka llogaritur dhe Komisioni, sipas standardit të INSTAT-it dhe ILDKPI-së.

9.10. *Për pasurinë apartament 1+1, ndodhur në lagjen “{***}”, Berat*, ankimi i Komisionerit Publik është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe nuk duhet të merret në konsideratë nga Kolegji, pasi në deklaratat periodike rezulton se është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit shumë qartë adresa e banimit, si dhe marrëdhënia me këtë apartament, ndërsa në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar për shkak se nuk ka qenë e formalizuar kontrata e qirasë. Për shkak se nuk ka pasur kontratë qiraje, pagesa e energjisë elektrike është bërë me librezën që ka qenë në emër të shtetasit G. C., i cili ka pasur një kontratë të mëparshme me pronarin e apartamentit në fjalë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar kronologjinë e pronësisë së apartamentit, si dhe ka sjellë disa akte si dokumente justifikuese për sqarimet e dhëna.

- 10.** Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur aktit apel kundërshtues, ka përcjellë në Kolegj dokumentet: (i) statement të “Raiffeisen Bank”, dega Berat, për shtetasen M. Z. për periudhën 01.09.2005-01.02.2022; (ii) kopje e librezës së energjisë elektrike në emër të G. C.; (iii) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 08.08.2012, midis G. C. dhe D. P., për anulimin e shitjes apartamentit; (iv) faturë tatimore/kopje elektronike, datë 30.05.2021, të Furnizuesit të Shërbimit Universal (në vijim FShU), në emër të G. C.; (v) faturë tatimore/kopje elektronike, datë 29.06.2021, të FShU-së, në emër të “{***}” ShPK; (vi) formular i kërkesës së aplikantit D. P., datë 21.06.2021, të OSShE-së, për ndryshim emri nga G. C. në “{***}” ShPK; (vii) kontratë shitblerje, datë 23.01.2022, nga “{***}” ShPK tek E. G.; si dhe (viii) kartela e pasurisë së paluajtshme elektronike e AShK /DV Berat, datë 28.01.2022, në emër të E. G. dhe A. C..

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit nga Komisioneri Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit në datën 25.11.2022, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh² nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 574, datë 18.10.2022, për subjektin e rivlerësimit Pëllumb Zaimi, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike të zhvilluar në prani të palëve.
14. Në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në seancën gjyqësore të datës 23.11.2023, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor, duke marrë në cilësinë e provës, për nevoja të hetimit gjyqësor, disa nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur apelit kundërshtues, si dhe me parashtrimet e datës 20.11.2023³. Trupi gjykues ia nënshtroi këto akte debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekti shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.

² Vendimi nr. 574, datë 18.10.2022, i Komisionit, për rivlerësimin e subjektit Pëllumb Zaimi, i është njoftuar Komisionerit Publik, sipas dokumentit lajmërimarrje, regjistruar nga institucioni i Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 10.11.2022.

³ Bashkëlidhur parashtrimeve të datës 20.11.2023, subjekti ka paraqitur aktet: 1) vendim nr. {***}, datë 21.04.2021, i Gjykatës së Lartë; 2) vendim mbi pushimin e gjykimit, nr. {***}, datë 04.04.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (2 fletë); 3) vërtetim nr. {***}, datë 16.11.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat; 4) vendimi i ILD-së për arkivimin e ankesës, nr. {***}, datë 22.02.2022 dhe shkresë njoftim vendimi nr. {***}, datë 22.02.2022; 5) kontratë dhurimi i aksioneve të "{***}" nr. {***} rep., nr.

15. Në Kolegj, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar disa denoncime nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes iu vunë paraprakisht në dispozicion subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar. Trupi gjykues, pas verifikimit të denoncimeve, vlerësoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendosi të mos i hetojë ato.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

- Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

16. Komisioneri Publik në ankim parashtroi se nga çështjet gjyqësore të analizuar për shkak të denoncimeve të paraqitura në Komision, ndër të tjera, janë evidentuar rrethana në të cilat duket se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit. Ky konstatim i Komisionerit bazohet në dy denoncimet e paraqitura në Komision nga shtetasit A. D. dhe K. L.. Shtetasi A. D. ka pretenduar për vendimmarrje të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin gjyqësor për një konflikt pronësie. Denoncuesi e lidh vendimmarrjen e gjykatës në rastin e tij edhe me pozitën e vajzës së subjektit të rivlerësimit, si drejtuese e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ASHK Berat), pasi konflikti gjyqësor ka si person të tretë këtë institucion, i cili, sipas padisë, kërkohet që, ndër të tjera, të bënte edhe regjistrimin e një sipërfaqeje toke. Denoncuesi pretendon se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për mospranimin e padisë së tij është e ndikuar nga ankesa që ka bërë në ASHK, pasi kur nga përfaqësuesja e tij në seancë gjyqësore është kërkuar që t'i merret informacion ASHK-së, subjekti i rivlerësimit ka orientuar që kërkimi të bëhet në portalin *e-albania*. Shtetasi K. L. në denoncimin drejtuar Komisionit, ndër të tjera, bën me dije se në mënyrë të ripërsëritur ka bërë kërkesë për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga zhvillimi i procesit gjyqësor të iniciuar prej tij me cilësinë e paditësit, me palë të paditur Bashkia Berat, ASHK Berat dhe shoqëria ndërtimore “{***}” ShPK, me objekt: “Pushim cenim pronësie dhe kallëzim i një

{***} kol., datë 15.11.2023; 6) urdhër regjistrimi procedimi penal nr. {***}, datë 10.10.2018; 7) kallëzim për ndjekje penale nr. {***} prot., datë 05.10.2018, i “{***}” SHA, Filiali Berat; 8) urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, datë 31.10.2018; 9) shkresë nr. {***} prot., datë 31.10.2018, e Drejtorisë së Policisë Berat; 10) procesverbal për kallëzimin e veprës penale i shtetasit Q. K./shkresa e DVP-së Berat me nr. {***} prot., datë 30.10.2018; 10) urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, datë 31.12.2018; 11) shkresë nr. {***} prot., datë 28.12.2018, e Drejtorisë së Policisë Berat; 12) procesverbal për kallëzimin e veprës penale i shtetasit S. Xh. datë 27.12.2018; 13) vendim për bashkimin e procedimeve datë 07.01.2019; 14) shkresë nr. {***} prot., datë 18.02.2019, e “{***}” SHA Filiali Berat me lëndë: “Shtesë në kallëzimin penal ndaj shtetasit S. T.”; 15) vendimi nr. {***}, datë 09.04.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; 16) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2019, e shtetasit Q. K.; 17) shkresë nr. {***} prot., datë 23.10.2019, “Kthim përgjigje” e Posta Shqiptare; 18) vendimi nr. {***}, datë 22.12.2022, i ILD-së së bashku me shkresën përcjellëse nr. {***} prot., datë 22.12.2022; 19) shkurtim vendimi nr. {***}, datë 15.09.2023, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; 20) Komente në facebook.

punimi të ri”. Denoncuesi pretendon për gjendje të konfliktit të interesit në këtë çështje pronësore me subjektin e rivlerësimit, për shkak se praktika e AShK-së Berat në adresë të tij është nënshkruar nga vajza e subjektit, si titullare e këtij institucioni dhe, në këtë kontekst, denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga çështja objekt gjykimi.

17. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe gjatë seancave publike të zhvilluara në Kolegj, ashtu si dhe në Komision në përgjigje të barrës së provës, ka prapësuar se çështjet janë regjistruar në gjykatë gjatë kohës që vajza e tij nuk ka qenë drejtuese e AShK-së, dhe se ky institucion në të 12 çështjet gjyqësore të shqyrtuara prej tij ka qenë në pozitën procedurale “person i tretë” dhe në të gjitha rastet nuk ka marrë pjesë në gjykim. Nga këto 12 vendime, në 2 raste, gjykata ka vendosur pranimin e padisë, në 2 raste ka vendosur rrëzimin e padisë, në 4 raste ka vendosur pushimin e gjykimit dhe në 4 rastet e tjera ka vendosur kthimin e kërkesë padisë dhe të akteve, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencë. Në të gjitha rastet e mësipërme, personi i tretë, AShK Berat, nuk ka pasur ndonjë rol në gjykim dhe asnjë interes të ligjshëm. Subjekti ka pretenduar se në asnjë rast të gjykimit të këtyre çështjeve nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit.
18. Komisioni, për denoncimin e shtetasit A. D., pasi ka konstatuar se: (i) në të gjitha vendimet, AShK/Drejtoria Vendore Berat është në cilësinë e personit të tretë; (ii) sipas udhëzimit të këtij institucioni, i cili rregullon procesin e ankimit ndaj vendimmarrjeve, rezultoi se kjo e drejtë ushtrohet vetëm në rastet kur nga vendimmarrjet cenohet interesi i ligjshëm i institucionit; (iii) për faktin se në të gjitha proceset gjyqësore rezultoi se institucioni ku drejtuese është vajza e subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e personit të tretë dhe, për pasojë, duke mos u tërhequr interesi i ligjshëm nga institucioni, kjo e drejtë nuk ushtrohet; (iv) në rastin objekt i këtij denoncimi, procesi gjyqësor është në të njëjtin stad, pra, konflikti është mes individëve dhe institucioni si person i tretë ka një rol tërësisht pasiv, ka arritur në përfundimin se në këtë rast nuk cenohet asnjë prej dispozitave ligjore në Kodin e Procedurës Civile, pasi në gjykimin e këtyre çështjeve duket të mos ketë rrethana konkrete apo arsye serioze njëanshmërie, sipas rasteve të parashikuara në nenin 72 të këtij Kodi. Gjithashtu, edhe referuar ligjit nr. 96/2016 apo edhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, duket se konflikti i interesit, në raport me pozitën e palës ndërgjyqëse në proces, mbetet në nivel të parëndësishëm.
19. Ndërsa për denoncimin e shtetasit K. L., Komisioni, duke iu referuar ankesës së këtij shtetasi në ILD dhe vendimit nr. {***} prot., datë 22.02.2022, të ILD-së, me të cilin është vendosur arkivimi i ankesës, ka konstatuar se në tërësi në vendimin e ILD-së duket se janë trajtuar të njëjtat problematika të denoncuar në Komision, si zvarritja në gjykim, moszhvillimi i seancave me audio, por edhe çështja e konfliktit të interesit. Në të tilla kushte, për sa kohë nga organi kompetent janë trajtuar të njëjtat problematika, Komisioni ka çmuar se mbivendosja e kompetencave tejkalon qëllimin e këtij procesi hetimor dhe, për pasojë, nuk mund të konkludojë për të njëjtat pretendime.

20. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe nga subjekti i rivlerësimit për sa i përket pozitës procedurale të personit të tretë AShK-së dhe vlerëson se të drejtat procedurale të personit të tretë janë të njëjta me ato të palëve në proces, përveç atyre të drejtave që përbëjnë disponim të objektit të padisë, dhe, se arsyet e njëanshmërisë nuk lidhen me rolin dhe pasojat e palëve ndërgjyqëse në proces, pasi nuk përjashtohet ligjërisht asnjë çështje, që të justifikojë qenien e gjyqtarit, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit në vendimmarrje. Gjithashtu, Komisioneri Publik e konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çështjet janë regjistruar në gjykatë para se vajza e subjektit të emërohej në detyrë, jo vetëm në drejtim të garantimit të paanësisë së trupit gjykues, por edhe të garantimit të perceptimit të publikut se drejtësia, jo vetëm po jepej, por edhe të dukej se po jepej. Sipas Komisionerit Publik, rastet e evidentuara më lart pasqyrojnë mungesën e kujdesit të pritshëm të subjektit të rivlerësimit, për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, qoftë dhe në dukje, në vlerësim të zbatimit të pikës 6, të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, e cila parashikon rastin se gjyqtari detyrohet të dorëhiqet në rast se ekzistojnë arsye serioze njëanshmërie. Në këto rrethana, Komisioneri Publik arrin në përfundimin se këto situata duhen trajtuar e konsideruar brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016, duke u vlerësuar në tërësi, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kriterëve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.
21. Trupi gjykues, nga aktet në fashikujt e Komisionit, konstaton se në verifikim të këtyre dy denoncimeve, Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat numrin e çështjeve të gjykuara nga subjekti me palë ndërgjyqëse ose person i tretë AShK-në, Drejtoria Vendore Berat, prej periudhës shkurt 2021, kohë në të cilën ka ushtruar dhe ushtron detyrën e drejtueses vajza e subjektit të rivlerësimit O. Z.. Në përgjigje, gjykata ka konfirmuar⁴ se janë gjykuar 12 çështje, ku palë ndërgjyqëse ose person i tretë ka qenë AShK-ja, Drejtoria Vendore Berat, prej datës 16.02.2021 e deri aktualisht (më 26.09.2022).
22. Në vlerësim të pretendimeve të Komisionerit Publik, si dhe të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se duhen analizuar qëndrimet për sa i përket pozitës së personit të tretë në raport me ekzistencën e një konflikti interesi. Kodi i Procedurës Civile në nenin 192 të tij ka përcaktuar se secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes. Ndërsa në nenin 193 të këtij Kodi parashikohet se gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë. Sipas parashikimeve të nenit 195 të këtij Kodi, personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve, përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë. Nga analizimi i dispozitave të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, personi i tretë është një subjekt

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

procedural në proces, që ka interes dhe impakt të drejtpërdrejtë që kushtëzohet nga mënyra e zgjidhjes gjyqësore të çështjes.

23. Trupi gjykues çmon se pavarësisht se nuk rezulton të ketë pasur interesa personale direkte të subjektit të rivlerësimit dhe të vajzës së tij, që do të çonin në një rast dukshëm të kategorizuar si konflikt interesi, subjekti i rivlerësimit, për shkak të pozitës së vajzës si drejtuese e institucionit të AShK-së, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në dukje⁵, për më tepër kur bëhet fjalë për një numër relativisht të konsiderueshëm çështjesh gjyqësore të gjykuara prej tij në një periudhë më pak se dy vjet gjatë së cilës e bija ka qenë drejtuese e AShK-së Berat. Ashtu si rezulton, edhe nga denoncimet dhe ankesat e palëve në institucione të tjera, vetëm fakti i qenies së gjyqtarit në lidhje të ngushtë familjare me drejtuesen e institucionit ka krijuar perceptimin se kjo lidhje familjare, përbën arsye serioze njëanshmërie, në kuptim të nenit 72⁶, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile dhe ka ndikuar në shqyrtimin e çështjes gjyqësore me paanshmëri dhe objektivitet, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut në dhënien e drejtësisë.
24. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se çështjet gjyqësore janë regjistruar para emërimit në detyrë të vajzës së tij, trupi gjykues vlerëson se momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatë nuk përbën relevancë që duhet të mbahet në konsideratë, pasi element thelbësor e me peshë konsiderohet momenti i shqyrtimit dhe zgjidhjes gjyqësore të çështjes, finalizuar dhe materializuar në vendimmarrjen përkatëse.
25. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se është i bazuar konstatimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore me palë të tretë AShK-në Berat, për periudhën kur ka qenë drejtuese vajza e tij, ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, dhe se ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit duhet trajtuar brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016, dhe vlerësuar në tërësi, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
26. Për sa i përket zotërimit të aksioneve pranë shoqërisë “{***}” ShA nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja M. Z., nga aktet në fashikujt e Komisionit rezulton se:
 - 26.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar zotërimin e aksioneve të “{***}” ShA .

⁵ Sipas nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

⁶ Neni 72 “Rastet për përjashtimin e gjyqtarit”: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose nga mbrojtësit; [...] 6. në çdo rast tjetër kur vëretohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

26.2. Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin dhe dorëzimin e bonove të privatizimit për vitin 1994, në vlerën prej 75.000 lekësh dhe nga bashkëshortja e tij në vlerën prej 50.000 lekësh, në degën e Thesarit Skrapar, për t'u bërë aksionarë në “{***}” ShA .

26.3. Subjekti ka depozituar në Komision vërtetimin nr. {***}, datë 19.04.2022, të “{***}” ShA , në të cilin pasqyrohet fakti i blerjes së aksioneve nga subjekti i rivlerësimit në vlerën prej 75.000 lekësh dhe nga bashkëshortja e tij në vlerën prej 50.000 lekësh (të cilat përbëjnë 0.00027% të kapitalit në “{***}”), si dhe fakti që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë përfituar dividendë nga kjo shoqëri, pasi Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “{***}” ShA nuk ka shpërndarë dividendë nga momenti i fitimit të titullit të pronësisë deri në datën e këtij vërtetimi.

27. Komisioni, pasi ka evidentuar gjatë hetimit zotërimin nga subjekti të aksioneve të “{***}” ShA , i ka kërkuar informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lidhur me zhvillimin nga subjekti i rivlerësimit të proceseve gjyqësore me palë ndërgjyqëse këtë shoqëri. Gjykata ka informuar se subjekti i rivlerësimit përgjatë ushtrimit të detyrës prej vitit 2014 e në vijim ka zhvilluar 16 procese gjyqësore me këtë palë ndërgjyqëse dhe, gjithashtu, edhe katër procese të tjera për periudhën 1999-2002. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka vënë në dispozicion të Komisionit vendime gjyqësore për çështje që shoqëria ka pasur në këtë gjykatë dhe që janë gjykuar prej vetë subjektit.
28. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë zotëruar aksione pranë kësaj shoqërie, duket se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 72, pika 1 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, por kjo shkelje nuk ka qenë në një nivel të tillë që mund të kualifikohet brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pikërisht duke konsideruar Parimet e Komentarit të Bangalores apo duke u vlerësuar kjo edhe në funksion të përfundimit të këtyre çështjeve me vendim të formës së prerë dhe interesit minimalist, pasi në rrethanat faktike nuk rezulton të ketë asnjë pasojë nga veprimtaria e ushtruar nga subjekti në lidhje me shoqërinë, sa i takon zhvillimit të gjykimeve.
29. Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, vlerëson se prapësimet e subjektit, si dhe qëndrimi i Komisionit nuk mbështeten në jurisprudencën dhe qëndrimet e Kolegjit në trajtimin e rasteve të ngjashme, lidhur me konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Në rastin konkret, gjykimi në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 72, pika 1 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton e provuar nga shqyrtimi dhe finalizimi i rreth 15⁷ çështjeve gjyqësore, me kërkuese shoqërinë “{***}” ShA ., ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të zotërojnë aksione pranë kësaj shoqërie. Komisioneri

⁷ Janë 16 çështje, sipas shkresës nr. {***} pot., datë 31.08.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, të cilat Komisioneri Publik i referon “rreth 15 çështje”.

Publik vlerëson se kjo gjendje e konfliktit të interesit e përsëritur, e vetme, nuk mund të prodhojë efektet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 apo nuk duket në një nivel të tillë që mund të kualifikonte rastin, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por këto fakte dhe rrethana, të padeklaruara nga subjekti dhe në deklaratën *vetting*, duhen vlerësuar në tërësi, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kriterëve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.

30. Subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, si dhe në prapësimet drejtuar Kolegjit, ka analizuar çështjet e gjykuara prej tij si gjyqtar me palë shoqërinë “{***}” ShA dhe ka qartësuar përfundimin e tyre së bashku me pasojat e sjella, si p.sh., në rastet e pushimit, për të cilat ka theksuar se vendimmarrjet nuk sjellin pasoja për palët në proces apo edhe për rastet e tjera të gjykuara, të cilat kanë përfunduar me vendime të formës së prerë. Po ashtu, subjekti ka referuar vendimin nr. 35, datë 23.11.2021, të Kolegjit, duke theksuar se vendimi interpreton dhe sqaron në mënyrë të detajuar se nuk është para rastit të konfliktit të interesit, edhe kur subjekti është aksionar në një shoqëri, në rastin konkret në “{***}” ShA , për shkak se vlera e këtyre aksioneve është e papërfillshme, minimaliste.
31. Në analizë të pretendimeve të të dy palëve, trupi gjykues vëren se në rastin konkret rezulton e provuar dhe e pranuar nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të zotërimit të aksioneve, referuar neneve 72, pika 1 dhe 73⁸ të Kodit të Procedurës Civile. Por Komisioni ka vlerësuar se kjo shkelje nuk ka qenë e tillë që të kualifikohet brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, duke referuar vendimin nr. 35/2021, të Kolegjit, se nuk është para rastit të konfliktit të interesit edhe kur subjekti është aksionar, për shkak të vlerës së papërfillshme, trupi gjykues tërheq vëmendjen në faktin se, bazuar dhe në kualifikimin e rastit të konfliktit të interesit që ka bërë Komisioni, si shkak ankimi i Komisionerit Publik nuk është konflikti i interesit për shkak të zotërimit të aksioneve, por gjykimi i çështjeve nga subjekti i rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit duke qenë aksionar i kësaj shoqërie.
32. Trupi gjykues vëren se rezulton e provuar nga vendimet gjyqësore që subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 16 çështje civile me kërkuese shoqërinë “{***}” ShA , ndërkohë që ka qenë aksionar i saj. Pavarësisht pretendimeve të subjektit për vlera të papërfillshme të aksioneve, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, me gjykimin e përsëritur të çështjeve me palë këtë shoqëri, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe duhet të kishte deklaruar heqjen dorë, sipas parashikimit të nenit 72, pika 6 të Kodit të

⁸Neni 73 “Heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes”: “Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit”.

Procedurës Civile. Për më tepër që nga verifikimi i 16 vendimeve gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në çështjet me palë paditëse “{***}” ShA dhe me objekt përmbushjen e detyrimeve kontraktore dhe lëshim urdhri ekzekutimi ndaj të tretëve, konstatohet se në 14 prej tyre subjekti ka vendosur pranimin e padisë dhe të kërkesës për rastet e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se mbetet i bazuar konstatimi i Komisionerit Publik se gjykimi i çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e konfliktit të interesit duke qenë aksionar i kësaj shoqërie, i ndërlidhur me mosdeklarimin e aksioneve në deklaratën *vetting*, pavarësisht se nuk e kualifikojnë rastin, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohen në zbatim të nenit 4, pika 2 të këtij ligji.

33. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë kujdesi për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, qoftë edhe në dukje, në vlerësim të zbatimit të pikës 6, të nenit 72 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile. Në gjykimin e çështjeve civile me palë ndërgjyqëse apo palë të tretë AShK-në, Drejtoria Vendore Berat, provohet ekzistenca e konfliktit të interesit në dukje për shkak të marrëdhënieve familjare, pasi vajza e subjektit ka qenë drejtuese e këtij institucioni për periudhën 16.02.2021-26.09.2022, në të cilën ai ka gjykuar 12 çështje civile me këtë subjekt procedural. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi në kohën kur së bashku me personin e lidhur (bashkëshorten) kanë qenë aksionarë të “{***}” ShA , ka gjykuar 16 çështje civile me palë paditëse/kërkuese këtë shoqëri. Trupi gjykues vlerëson se denoncimet e publikut dhe çështje të tjera të konstatuara në dosjet gjyqësore të analizuara nga Komisioni, mbi të cilat është bazuar ankimi i Komisionerit Publik, janë dëshmi të perceptimit publik se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parimin se *drejtësia, jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se po jepet*.
34. Komisioneri Publik, duke iu referuar disa çështjeve penale të gjykuara prej subjektit të rivlerësimit, nisur dhe nga jurisprudenca e Kolegjit, vlerëson se shkeljet e konstatuara në dosjet penale që administrohen në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, marrin tjetër kuptim e peshë në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese. Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se këto çështje, në kuptim të këtij procesi, duhen trajtuar si pjesë e rezultateve të hetimit administrativ mbi kontrollin e figurës dhe Kolegji i merr parasysh ato në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur sa më sipër, për çështjet penale të cilave u referohet Komisioneri Publik, analizohet si në vijim.
35. **Për vendimin penal nr. {***}, datë 10.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat**, nga aktet në fashikuj rezulton se në ngarkim të shtetasit S. T., mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Q. K., është regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 31.10.2018, për veprën penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Gjatë gjykimin të çështjes, nga përfaqësuesi i organit të akuzës është konstatuar se personi nën hetim, S. T., është dënuar më parë për të njëjtin fakt penal, me vendimin e formës së prerë nr. {***}, datë 26.06.2019, me

katër muaj burgim, pasi më parë ndaj tij ishte regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 10.10.2018, mbi kallëzimin e Filialit të “{***}” ShA, për vjedhje të pensionit të shtetasit Q. K.. Përfaqësuesi i organit të akuzës, i cili ka vënë në lëvizje gjykatën në këtë proces gjyqësor, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 31.10.2018, kërkesë për të cilën është dakordësuar edhe personi nën hetim dhe, po ashtu, edhe viktima. Në të tilla kushte, subjekti i rivlerësimit, si gjyqtar i çështjes, ka vendosur pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të organit të akuzës dhe, për pasojë, është vendosur pushimi i çështjes, vendim i cili rezulton të jetë i formës së prerë.

36. Komisioni në përfundim të hetimit, lidhur me këtë vendim gjyqësor, nuk ka konstatuar ndonjë problematikë faktike a ligjore që mund të cenojë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të subjektit.

37. Komisioneri Publik, në ndryshim nga Komisioni, ka konstatuar problematika në dhënien e këtij vendimi, duke parashtruar në ankim se nuk qëndron disponimi nga subjekti i rivlerësimit se: *i pandehuri është dënuar me vendim të formës së prerë për të njëjtën veprë penale*, për këto arsye:

37.1. Vendimi penal nr. {***}, datë 10.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit ka për palë kërkuese Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, shtetas nën hetim, S. T. dhe viktimë shtetasin Q. K.. Objekt i kësaj çështjeje penale është shqyrtimi i kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 31.10.2018, për veprën penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Ndërsa vendimi penal nr. {***}, datë 26.06.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me gjyqtare znj. M. Ll., ka për palë në cilësinë e të pandehurit shtetasin S. T., me viktimë Shoqëria {***} ShA, Filiali Berat, me akuzë për kryerjen e veprës penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, sipas procedimit penal nr. {***}, datë 10.10.2018.

37.2. Në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik ka kundërshtuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në këtë rast vepra penale e kryer nga shtetasi nën hetim S. T. konsiderohet si krim vazhdues, për të cilin është dënuar një herë, sipas parashikimeve të nenit 135 të Kodit Penal. Sipas Komisionerit Publik, referuar praktikës gjyqësore dhe mënyrës së formulimit të dispozitave të seksionit I “Vjedhja e pasurisë”, të Kodit Penal, vepra penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, e parashikuar nga neni 135 i këtij Kodi, nuk parashikon si anë objektive kryerjen më shumë se njëherë të veprës penale ndaj dhe nuk mund të kualifikohet si krim vazhdues, pasi akti mund të qëndrojë si akt më vete.

37.3. Nga përmbajtja e vendimit penal nr. {***}, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ka shërbyer si mbështetje ligjore për të disponuar me vendimin e pranimit të kërkesës së pushimit të çështjes penale nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. {***}, datë 10.12.2019, të po kësaj gjykate, rezulton se persona të dëmtuar janë disa shtetas, të cilët

janë ankuar dhe kanë dhënë deklarime pranë {***} ShA, Filiali Berat, e cila më pas inicioi kallëzimin penal, ku mes të cilëve nuk rezulton të ketë qenë shtetasi Q. K., duke mos pasur asnjë pozitë procedurale. Në vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në pjesën arsyetuese, ku përshkruhen rrethanat lehtësuese, citohet edhe *deklaratë noteriale e datës 20.06.2019* e shtetasit Q. K., por jo në cilësinë e personit të dëmtuar, pra, duke u evidentuar fakti se shtetasi Q. K. nuk ka qenë në grupin e personave të dëmtuar, në episodin për të cilin ka bërë kallëzim Filiali i {***} ShA, Berat.

38. Komisioneri Publik konstaton se, për sa kohë kjo çështje është trajtuar nga Komisioni në kuadër të të dhënave të administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e pasurisë dhe të aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe parë në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 të po këtij ligji.

39. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në apelin kundërshtues drejtuar Kolegjit se vendimi penal nr. {***}, datë 10.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik, është i bazuar në ligj dhe në prova dhe në dhënien e tij nuk ka mangësi profesionale dhe të njohurive ligjore. Në aktet e procedimit penal nr. {***} janë edhe aktet e kallëzimit penal të depozituar në prokurori nga “{***}” ShA edhe për vjedhjen e një sasive lekësh të pensionit të shtetasit Q. K.. Subjekti i rivlerësimit, si gjyqtar i çështjes, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit S. T., pasi shtetasi nën hetim është dënuar për të njëjtin fakt penal me vendim të formës së prerë. Kallëzuesi/viktima, që ka qenë prezent në gjykimin e kërkesës penale nr. {***}, nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 10.12.2019, çka tregon se ka qenë dakord me vendimin e gjykatës.

40. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik, pasi verifikoi aktet e administruara nga Komisioni dhe ato të administruara gjatë gjykimit në Kolegji, trupi gjykues, lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

40.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, në çështjen penale nr. {***}, me kërkues prokurorinë, shtetas nën hetim S. T. dhe viktimë Q. K., bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “e”⁹ e Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit S. T., pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019, për procedimin penal nr. {***}, e ka deklaruar fajtor shtetasin S. T. dhe rezulton të ndodhemi para të njëjtit fakt penal, i cili është hetuar dhe gjykuar.

⁹ Neni 328: “Në përfundim të hetimeve paraprake [...] prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur [...] e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale”.

40.2. Në vendimin nr. {***}, datë 10.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: - *Pranimin e kërkesës së kërkuesit, prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. - Pushimin e çështjes penale nr. {***}, që i përket procedimit penal nr. {***}, datë 31.10.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për veprën penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën” të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, pasi i pandehuri është dënuar me vendim të formës së prerë për të njëjtën veprë penale.*

41. Nga aktet e të dy procedimeve penale, rezulton se procedimi penal nr. {***}, datë 10.10.2018, është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të Filialit Berat të {***} ShA, ndërsa procedimi penal nr. {***}, datë 31.10.2018, është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Q. K.. Sipas vendimit nr. {***}, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për procedimin penal nr. {***}, datë 10.10.2018, subjekt procedural/viktimë ka qenë Filiali Berat i {***} ShA, ndërsa sipas vendimit nr. {***}, datë 10.12.2019, të po kësaj gjykate, subjekt procedural/viktimë ka qenë shtetasi Q. K.. Bazuar në aktet, si dhe në dy vendimet gjyqësore të sipërcituara, trupi gjykues vëren se për shkak të subjekteve të ndryshme procedurale që kanë bërë kallëzimin dhe që rezultojnë pjesëmarrës në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve penale, personi i akuzuar/personin nën hetim duhet të gjykohej dhe dënohej veçmas për të dy këto procedime penale, dhe se nuk mund të konsiderohej se dënimi i dhënë me vendimin nr. {***}, për procedimin penal nr. {***}, përjashtonte dënimin e tij për procedimin penal nr. {***}.
42. Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimit të subjektit se në këtë rast bëhet fjalë për një krim vazhdues, sjell në vëmendje se lidhur me analizën e çështjes nëse ndaj personit të pandehur duhet të jepej dënim për secilin procedim penal, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 284, datë 06.10.2000, në interpretim të nenit 143 të Kodit Penal, që bën fjalë për veprën penale të vjedhjes nëpërmjet mashtrimit, kanë mbajtur qëndrimin se në rastin e kësaj dispozite, si dhe për dispozita të tjera të Kodit Penal, kur “kryerja e veprës më shumë se një herë” apo “përsëritja” nuk parashikohen si elementë përbërës të veprës penale, personi fajtor do të përgjigjet penalisht për aq vepra penale që ai kryen. Neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën” nuk e parashikon si anë objektive kryerjen më shumë se njëherë të veprës penale dhe, për rrjedhojë, bazuar në vendimin e mësipërm unifikues, personi që e ka kryer vjedhjen do të përgjigjet penalisht aq herë për të, sa të jetë numri i personave të dëmtuar, pavarësisht nga fakti se vjedhja është bërë në të njëjtën kohë apo me shkoputje ndaj personave të dëmtuar.
43. Në rastin konkret, me vendimin penal nr. {***}, datë 10.12.2019, subjekti i rivlerësimit, duke vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal me argumentin se i pandehuri S. T. ka kryer krim vazhdues dhe duhej deklaruar fajtor dhe dënuar vetëm një herë për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, ka vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 284, datë 06.10.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit i pandehuri duhet të deklarohej fajtor dhe të dënohej dy herë për kryerjen e kësaj vepre, për arsye se vjedhja ishte kryer në dëm të dy subjekteve/personave të ndryshëm.

44. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për miratimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. {***}, me argumentin se personi është dënuar për të njëjtën vepër penale, është i pabazuar në ligj dhe nuk përputhet me faktet e çështjes. Për rrjedhojë, gjenden të bazuara konstatimet e Komisionerit Publik për mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e kësaj çështjeje, në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.
45. **Me vendimin penal nr. {***}, datë 26.12.2013**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë ndaj shtetasit K. S., duke vendosur masën e sigurimit personal të detyrimit për paraqitje ndaj këtij shtetasi, i akuzuar për drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar në vendimin e tij kriteret e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale duke cituar *se mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në Kodin Penal [...] shtetasi S. nuk njihet si person me tendencë kriminale dhe nuk rezulton person i dënuar [...] ai njihet si person punëtor, korrekt në shoqëri dhe me sjellje të mirë*. Vendimi, më tej, është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 04.02.2014, ka vendosur mospranimin e ankimit të organit të akuzës, për shkak të heqjes dorë nga ankimi nga përfaqësuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
46. Komisioni, pas verifikimit të akteve të fashikullit gjyqësor¹⁰, i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentin që provon gjendjen gjyqësore të të akuzuarit, pasi sikurse theksohet në vendim ai ka rezultuar i padënuar, si dhe çdo dokumentacionin që ka ndikuar në provueshmërinë e rrethanave lehtësuese.
47. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit, ka shpjeguar se: (a) gjykimi është zhvilluar sipas neneve 259 dhe 244 të Kodit të Procedurës Penale; (b) gjykimi është zhvilluar me praninë e prokurorit dhe në dosje janë administruar vetëm provat e përcjella prej tij nëpërmjet fashikullit penal; (c) subjekti ka shpjeguar se kërkimet e Komisionit janë prova të cilësuar në aktet e fashikullit të organit të akuzës, si p. sh., në vleftësimin e arrestit në flagrancë thuhet se ky shtetas është i padënuar, cilëson gjendjen civile i martuar, etj.; (ç) subjekti ka konfirmuar se vendimmarrja e tij ka mbetur në fuqi edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke u vendosur mospranimi i ankimit.
48. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se nuk evidentohen problematika lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016, që mund të cenojnë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të subjektit.
49. Komisioneri Publik, ndryshe nga qëndrimi i Komisionit, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka

¹⁰ Përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me shkresën nr. {***} prot., datë 10.01.2022.

treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, pasi vlerëson se duhet të tregonte kujdesin e nevojshëm, bazuar në kërkesat e paragrafit 1, të nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, duke administruar në cilësinë e provës, aktin përkatës/vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasit K. S., lëshuar nga organi i përcaktuar në nenin 484 të Kodit të Procedurës Penale.

50. Në apelin kundërshtues, subjekti parashtron se ky vendim është dhënë lidhur me kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, me objekt “Vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal”. Sipas subjektit, në gjykimin e këtyre kërkesave, provat dhe aktet në seancë gjyqësore i paraqesin palët, prokurori dhe i arrestuari/mbrojtësi i tij dhe nuk është detyrë e gjykatës në këtë lloj gjykimi të marrë vetë akte dhe prova. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 484 të Kodit të Procedurës Penale, vërtetimin e gjendjes gjyqësore në këtë gjykim duhet ta paraqisnin palët. Nga aktet dhe provat e paraqitura nga prokurori, të shqyrtuara dhe administruara në seancë gjyqësore, ka rezultuar se shtetasi K. S. nuk rezulton i dënuar më parë dhe ky fakt është pasur parasysh nga gjykata në dhënien e vendimit përfundimtar.
51. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, se lloji i gjykimin, në rastin konkret vlerësimi i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit personal, nuk përcakton dhe nuk përjashton përgjegjësinë e gjyqtarit të çështjes për të vlerësuar mbi rrethanat dhe aktet e fashikullit penal, si dhe për të kontrolluar, sipas rastit, përmbushjen e rrethanave lehtësuese apo rënduese të personit në hetim. Nga aktet në fashikull konstatohet se prokurori, bashkë me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë drejtuar gjykatës, ka paraqitur vetëm aktet e hetimit paraprak të çështjes. Rezulton se gjyqtari ka rreshtuar në vendim rrethanat lehtësuese se *shtetasi K. S. nuk njihet si person me tendencë kriminale dhe nuk rezulton i dënuar*, mbi të cilat ka argumentuar marrjen e një mase sigurimi më të lehtë (detyrim paraqitje), nga ajo që ka kërkuar prokurori, por pa iu referuar akteve/provave konkrete të fashikullit mbi të cilat është bazuar për këtë vendimmarrje. Trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të konsiderohej pretendimi i subjektit se nuk është detyrë e gjykatës të marrë akte në këtë lloj gjykimi, është i rëndësishëm fakti që ai si gjyqtar ka dhënë një vendim të pambështetur në rrethana dhe në akte, sipas parashikimeve të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se në caktimin e masave të sigurimit nga gjykata mbahet parasysh dhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.
52. Trupi gjykues vëren se nuk qëndron as argumenti i sjellë nga subjekti i rivlerësimit se vendimi është pranuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, pasi nga verifikimi i përmbajtjes rezulton se kjo gjykatë ka disponuar me vendim pas kërkesës për heqje dorë nga ankimi nga prokuroria dhe nuk e ka marrë në shqyrtim vendimin e shkallës së parë, për rrjedhojë nuk ka vlerësuar bazueshmërinë ose jo të këtij vendimi.

53. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se qëndrojnë konstatimet e Komisionerit Publik se në trajtimin e kësaj çështjeje subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në treguesin e njohurive ligjore, sipas parashikimeve të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.
54. Për sa i përket **denoncimit të shtetasit B. M.**, i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit ka manifestuar shkelje të etikës profesionale, duke përdorur një fjalor aspak etik dhe profesional gjatë seancës gjyqësore, Komisioni ka administruar kopje të dosjes gjyqësore të çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 17.07.2020, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe kopje të CD-së së seancave gjyqësore. Sipas rezultateve të hetimit, Komisioni, nga dëgjimi që i ka bërë CD-së, ndër të tjera, ka konstatuar hera-herës shprehje drejtuar palës ndërgjyqëse, të cilat duken joetike për figurën e magjistratit, tej komunikimit zyrtar.
55. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar, midis të tjerave se: (i) është bërë verifikimi i prezencës së palëve dhe është kërkuar identifikimi me mjetin përkatës; (ii) babai i denoncuesit, i cili ka vënë në lëvizje gjykatën me ankim ndaj mosfillimit të vendimit, shtetasi Q. M., është paraqitur pa mjet identifikimi; (iii) denoncuesi ka marrë pjesë në seancë dhe ka ndërhyrë disa herë, duke përdorur fjalë dhe kryer veprime e duke folur në telefon; (iv) nëpërmjet punonjësit të sigurisë ka kërkuar urdhërimin e daljes nga seanca të shtetasit B. M.. Subjekti ka shpjeguar kuptimin gjuhësor të shprehjeve të përdorura dhe rrethanave të zhvillimit të seancës gjyqësore dhe ka theksuar se shprehjet e përdorura prej tij nuk përbëjnë shkelje të etikës së figurës së magjistratit dhe, njëkohësisht, ka qartësuar edhe statusin e çështjes, për të cilën është vendosur rrëzimi i kërkesës dhe, më tej, nuk është pranuar ankimi.
56. Komisioni ka konstatuar se subjekti nga njëra anë ka pranuar përdorimin e disa shprehjeve jo të duhura, por nga ana tjetër ka qartësuar edhe kuptimin e tyre, duke pretenduar se shprehjet nuk u janë adresuar palëve në gjykim, por se ato janë drejtuar në një moment të caktuar për shkak të mosruajtjes së qetësisë nga palët në gjykim. Komisioni, duke pasur në konsideratë faktin e përdorimit të shprehjeve jo të duhura gjatë ushtrimit të detyrës ku kërkohet solemnitet dhe në raport me vendin e përdorimit të tyre, ka çmuar se subjekti, si magjistrat në sistemin e drejtësisë, duhet të evitojë çdo fjalor joetik, pavarësisht situatës që e dikton atë. Në konkluzion, Komisioni, në raport me shpjegimet e subjektit mbi rrethanën që i ka përdorur këto shprehje, ka vlerësuar se kjo mangësi, duke qenë një rast i veçuar në veprimtarinë e punës së subjektit, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut të qenësishëm për penalizim të tij.
57. Komisioneri Publik, në ankimin drejtuar Kolegjit, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, vlerëson se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në komunikimin mes tij dhe palëve ndërgjyqëse, në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, përbëjnë sjellje që nuk i shërben këtij qëllimi. Sikundër konstaton dhe Komisioni, verifikohet se subjekti ka përdorur shprehje joetike për figurën e magjistratit, të tilla që cenojnë parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore, (parimin e integritetit, sjelljes së hijshme dhe vetëpërmbytjes, respektit dhe aftësisë për të

dëgjuar etj.), duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 75, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016 dhe duhen vlerësuar nga Kolegji në tërësi, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

58. Në apelin kundërshtues, subjekti i rivlerësimit kundërshton pretendimin e Komisionerit Publik se gjuha e përdorur në komunikimin mes tij dhe palëve ndërgjyqëse është në shkelje të Kodit të Etikës dhe përbën sjellje që nuk i shërben qëllimit të rikthimit të besimit të publikut te drejtësia. Sipas subjektit, denoncuesi nuk ka qenë palë ndërgjyqëse, siç pretendon Komisioneri Publik, por është lejuar në sallën e gjyqit të marrë pjesë si dëgjues, ndërkohë që ka kryer veprime me të cilat ka prishur rregullin dhe qetësinë e seancës gjyqësore.
59. Në vlerësim të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni (regjistrimi audio), trupi gjykues konstaton, ashtu si dhe është vërejtur nga Komisioni, se gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, për çështjen së cilës i referohet denoncuesi, subjekti i rivlerësimit ka përdorur fjalë me konotacion negativ dhe ka komunikuar me pjesëmarrësit në kundërshtim me rregullat e sjelljes dhe etikën e një gjyqtari. Trupi gjykues çmon se është i pabazuar konstatimi/justifikimi i subjektit të rivlerësimit se personi i prekur nuk ka qenë palë ndërgjyqëse, pasi respektimi i rregullave të etikës nga gjyqtari në një seancë gjyqësore publike, si dhe ruajtja e solemnitetit në gjykim, duhet të bëhet për të gjithë pjesëmarrësit në sallën e gjyqimit, pavarësisht rolit procedural që ata kanë. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se sjellja e subjektit çon në vlerësimin e tij me mangësi profesionale për indikatorin e parashikuar nga neni 75, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016 dhe duhet konsideruar në vlerësimin në tërësi në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
60. **Për denoncimin e shtetasit B. T.,** Komisioni ka konkluduar se në vlerësim të shpjegimeve të dhëna, legjislacionit të aplikueshëm, i cili në këto raste i jep të drejtë secilës palë të dëmtuar në mënyrë të veçantë të ushtrojë ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë, si dhe faktit që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është ligjëruar nga gjykata më e lartë, nuk konstaton problematika, të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.
61. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se nga të dhënat e administruara nga denoncimi konstatohen problematika në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të cilat duhen evidentuar dhe çmuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. *Së pari*, Komisioneri Publik vlerëson se fakti që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është konfirmuar nga gjykata më e lartë nuk mund të jetë kriteri matës i vetëm përcaktues për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për më tepër kur lidhet me aspekte të respektimit të ligjit procedural, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji në jurisprudencën e tij. Qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta nuk duhen përdorur për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët. *Së dyti*, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vendimin penal nr. {***}, datë 25.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka disponuar duke shpallur fajtorë

shtetas, të cilët më parë, për të njëjtën vepër penale, për të njëjtin konflikt, mbi të njëjtat prova shkresore, kanë qenë palë akuzuese dhe, me vendim gjykate, kanë provuar se kanë qenë të dëmtuar nga personi/kërkuesi. Në përfundim, për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik, nisur dhe nga argumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, vlerëson se ka elemente për t'u vlerësuar në drejtim të indikatorit të aspektit të njohurive ligjore, referuar nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, konkretisht mbi interpretimin e parimeve ligjore, që rregullojnë institutin e sigurisë juridike.

62. Për këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit parashtroi se kemi të bëjmë me dy kërkesa penale/gjykime të ndryshme, të cilat janë gjykuar nga gjykata me trupa gjykuese të ndryshme. Provat e administruara dhe të shqyrtuara në kërkesën penale nr. {***} dhe në kërkesën penale nr. {***}, nuk kanë qenë të njëjta, kurse konflikti midis palëve ka ndodhur në datën 08.05.2019, me shtrirje në kohë. Ata janë konfliktuar brenda ditës dy herë me njëri-tjetrin, në vende të ndryshme. Në arsyetimin e vendimit penal nr. {***}, datë 25.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit për kërkesën penale nr. {***}, ka rezultuar e provuar se të akuzuarit B. T. dhe N. T. nuk kanë paraqitur asnjë provë në gjykim për të vërtetuar pafajësinë e tyre, përkundrazi, nga provat e paraqitura nga viktimat, ka rezultuar se këta shtetas kanë kryer kundërvajtjen penale dhe në përfundim të gjykimit janë deklaruar fajtorë. Vendimi penal nr. {***}, datë 25.10.2021, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.
63. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, konstaton se bëhet fjalë për një ngjarje të ndodhur në datën 08.05.2019, midis shtetasit T. P. dhe shtetasve B. T. e N. T.. Rezulton se për këtë ngjarje janë regjistruar dy procedime penale, procedimi i parë regjistruar në datën 17.05.2019 dhe procedimi i dytë në datën 12.05.2021 (dy vjet pas të parit).
64. Lidhur me procedimin e parë, me palë i dëmtuar akuzues B. dhe N. T. dhe me të akuzuar T. P., me akuzë për kryerjen e veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin penal nr. {***}, datë 06.12.2019, me gjyqtar një subjekt tjetër rivlerësimi ka vendosur deklarinin fajtor të të akuzuarit T. P. dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 50.000 lekë gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 25.06.2020, për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, fajësinë dhe shpenzimet gjyqësore dhe ndryshimin për pjesën tjetër, duke e dënuar me 1 (një) muaj burg të akuzuarin.
65. Për procedimin e dytë, me palë i dëmtuar akuzues T. P. dhe me të akuzuar B. dhe N. T., me akuzë për kryerjen e veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin penal nr. {***}, datë 25.10.2021, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, ka vendosur deklarinin fajtor të të akuzuarit B. T. dhe të akuzuarës N. T. dhe dënimin e zotit B. T. me 60.000 lekë gjobë dhe znj. N. T. me 50.000 lekë gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 14.09.2022.

66. Trupi gjykues konstaton nga aktet referuar më sipër se në të dy vendimet gjykatat i referohen të njëjtës ngjarje, me të njëjtat palë dhe për të njëjtën vepër penale, të parashikuar në nenin 90/2 të Kodit Penal. Vendimi i parë nr. {***}, datë 06.12.2019, është lënë pjesërisht në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, është bërë ekzekutimi i këtij vendimi, si dhe nuk është ushtruar rekurs ndaj tij. Nëse subjekti i rivlerësimit do të verifikonte gjendjen gjyqësore të palëve në proces do të rezultonte se personi që kishte ngritur akuzën ishte dënua më parë, me vendim të formës së prerë, lidhur me të njëjtin konflikt.
67. Gjithashtu, konstatohet se në të dy vendimet janë përdorur të njëjtat prova shkresore, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, datë 13.05.2019, “Mbi ekzaminimin e shtetasit T. P.”, është përdorur në të dy procedimet penale, në kundërshtim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit se provat e administruara dhe të shqyrtuara nuk kanë qenë të njëjta.
68. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se janë të bazuara konstatimet e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, referuar nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, konkretisht mbi interpretimin e parimeve ligjore, që rregullojnë institutin e sigurisë juridike. Në bazë të parimit të “gjësë së gjykuar”, kur gjykimi i parë ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, asnjë gjykatë nuk mund të gjykojë sërish të njëjtën çështje me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor.
69. **Denoncuesi A. S.**, në denoncimin e paraqitur në Komision ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime haptazi të njëanshme kundër të drejtave të të pandehurve në gjykimin e çështjes penale ku kërkues/i pandehur ka qenë djali i tij. Denoncuesi pretendon se është shkelur afati 12-mujor i qëndrimit të të pandehurve në paraburgim dhe, për pasojë, është shkelur neni 263/2 i Kodit të Procedurës Penale, pasi praktika njehsuese e Kolegjit të Gjykatës së Lartë, sipas vendimit nr. 62, datë 01.11.2021, afatin 12-mujor e parashikon të nisur prej momentit të dorëzimit të akteve për gjykim në gjykatë nga organi i akuzës, për rastet kur nga gjyqtari paraprak është vendosur kalimi i çështjes për gjykim. Në vendimin e praktikës njehsuese citohet: *Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjyimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq.*
70. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni ka konkluduar se: (i) për sa kohë çështja duket të jetë komplekse; (ii) po ashtu për sa rezultoi se për kërkesat e shuarjes së masës së sigurimit janë ndërmarrë një sërë veprimesh apo edhe vendimmarrje; (iii) në një kohë që Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk është shprehur lidhur me afatin tërësor të paraburgimit; (iv) pa zëvendësuar logjikën e arsytimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk mund të konkludojë në problematika ndaj subjektit të rivlerësimit.
71. Komisioneri Publik, referuar të dhënave të çështjes penale nr. {***}, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi vendimi i ndërmjetëm, datë 11.02.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku një nga anëtarët është

subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, i lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 27.04.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga të dhëna të marra nga burime të hapura të informacionit, rezulton të jetë prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr. {***}, datë 13.10.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 134, datë 27.04.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në vendimin e tij nr. {***}, datë 13.10.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të gabuar arsyetimin dhe disponimin e gjykatave të faktit në rastin konkret.

72. Për këtë denoncim, subjekti prapëson konstatimet e Komisionerit Publik, duke parashtruar se vendimi nr. {***}, datë 13.10.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka konstatuar mangësi dhe ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe jo vendimin e gjykatës së shkallës së parë në trupin gjykues të së cilës ka qenë anëtar subjekti i rivlerësimit. Vendimet e ndërmjetme të dhëna nga trupi gjykues për shuarjen e masës së sigurisë kanë ngelur në fuqi në Gjykatën e Apelit Vlorë, ndërsa vendimi penal i themelit ka ngelur në fuqi me vendimin e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit Tiranë, me nr. {***}, datë 15.09.2023 dhe të pandehurit janë duke vuajtur dënimet e rënda me burgim.
73. Kolegji, pas shqyrtimit të përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, në këndvështrim të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pjesë e trupit gjykues të së cilës ka qenë edhe subjekti, me vendimin e ndërmjetëm nr. {***}, datë 11.02.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit të kërkuarit D. E. (djali i denoncuesit) dhe personave të tjerë të akuzuar për veprat penale “Vrasje në rrethana lehtësuese, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë” dhe “Armëmbajtje pa leje”, të parashikuara nga nenet 79/dh-22-25 dhe 278/1 të Kodit Penal. Me vendimin nr. {***}, datë 27.04.2022, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 11.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.
74. Referuar vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 13.10.2022, rezulton se [...] Kolegji vlerëson se kërkesa e kërkuarve D. E., I. M., A. G., G. D. është depozituar gjatë momentit procedural në të cilin ata kanë qenë në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, pra, të pandehurit kanë qenë duke u gjykuar në themel për akuzat e ngritura nga prokuroria. Në pretendimet e tyre përfaqësuesit e të pandehurve pretendojnë se afatet e paraburgimit kanë kaluar për sa i përket fazës së regjistrimit të çështjes pranë gjyqtarit të seancës paraprake dhe kalimit të çështjes në themel, të cilat nuk duhet të jenë mbi 12 muaj referuar veprave penale për të cilën akuzohen të pandehurit. Masa e sigurimit është një element procedural dinamik e cila mund të ndryshojë nga momenti i kërimit deri në momentin e gjykimit duke e bërë që kërkit i kërkuarve të ndryshojë ose të bjerë për shkak të ndryshimit të rrethanave. [...] Bazuar sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave të faktit, për sa i përket përlllogaritjes të afatit të paraburgimit të konsumuar prej të pandehurve D. E., I. M., A. G., G. D., nga faktet e pranuar nga gjykatat, është i gabuar. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga kërkuarve D. E., I. M., A. G., G. D., kundër vendimit me nr. {***}, datë

27.04.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të pranohet, për sa i përket interpretimit të gabuar të bërë nga Gjykata e Apelit Vlorë në lidhje me interpretimin se kujt faze procedurale i përkasin afatet e paraburgimit [...]”.

75. Trupi gjykues, në vlerësimin e këtij shkak ankimi, sjell në vëmendje jurisprudencën¹¹ e tij, sipas së cilës Kolegji nuk është një gjykatë më e lartë, në kuptim të vlerësimit të korrektësisë së vendimmarrjes dhe zgjidhjes së themelit të çështjeve të trajtuara prej subjekteve të rivlerësimit, por, për llogari të funksionit kushtetues të vlerësimit të aftësive të tyre profesionale, vlerëson se sipas parashikimit kushtetues të nenit E, paragrafi 4 i Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, duhet të mbahen në konsideratë dy elementet përbërëse të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, përkatësisht njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor.
76. Referuar rastit konkret, trupi gjykues vlerëson se analiza dhe arsyetimi ligjor i dhënë në këtë rast nga gjykata, në lidhje me interpretimin se cilës fazë procedurale i përkasin afatet e paraburgimit, si dhe për përlllogaritjen e këtyre afateve, të çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit demonstroi në këto rrethana mungesë të aftësive profesionale të gjyqtarit, në drejtim të aftësisë për të interpretuar në mënyrën e duhur ligjin procedural në çështjen konkrete, tregues që lidhet me aspektin e njohurive ligjore, sipas kuptimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe kjo mangësi do të konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të aftësisë profesionale të subjektit në kuadër të procesit të rivlerësimit.
77. Subjekti i rivlerësimit pretendon dhe se vendimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë është shprehur për zbatim të gabuar të ligjit procedural penal nga Gjykata e Apelit Vlorë, dhe se nuk bëhet fjalë për interpretim të gabuar të ligjit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pjesë e vendimmarrjes së të cilës ka qenë subjekti dhe se vendimi i datës 11.02.2022 ka mbetur ende në fuqi. Trupi gjykues vëren se ky pretendim i subjektit është i pabazuar, pasi pavarësisht se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur *prishjen e vendimit nr. {***}, datë 27.04.2022, të Gjykatës së Apelit¹² Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues*, në argumentimin e dhënë në këtë vendim Kolegji Penal është shprehur se *vendimmarrja e gjykatave të faktit, për sa i përket përlllogaritjes të afatit të paraburgimit të konsumuar prej të pandehurve D. E., I. M., A. G., G. D., nga faktet e pranuar nga gjykatat, është i gabuar.*
78. Për sa më sipër, trupi gjykues për këtë shkak ankimi vlerëson si të bazuara konstatimet e Komisionerit Publik për mangësi profesionale të subjekti të rivlerësimit në trajtimin e kësaj çështjeje në treguesin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

¹¹ *Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 9/2020.*

¹² *Ndërkohë Gjykata e Apelit e ka gjetur të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, sipas së cilës edhe afatet tërësore të paraburgimit të mos kenë kaluar e në këtë kuptim, nuk gjen zbatim neni 263, pika 6, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale.*

79. Në konkluzion, nga vlerësimi i çështjeve penale dhe denoncimeve të publikut të paraqitura si shkaqe ankimi nga Komisioneri Publik, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale dhe mungesë të njohurive ligjore në trajtimin e këtyre çështjeve, sipas nenit 72, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në gjykimin e këtyre çështjeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e nevojshëm në interpretimin e parimit të sigurisë juridike, në administrimin e provave, në aplikimin e drejtë të ligjit procedural, si dhe ka shfaqur mungesë etike në komunikimin me palët dhe pjesëmarrësit në seancat gjyqësore publike, duke sjellë një perceptim të gabuar të publikut në dhënien e drejtësisë.

- **Lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

80. *Për pasurinë apartament, me sipërfaqe 86 m², ndodhur në {***}, Tiranë*, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative në shumën prej 212.256 lekësh për vitin 2005 dhe në shumën prej 142.189 lekësh për vitin 2008 dhe, nisur nga masa dhe dinamika e pamjaftueshmërisë financiare të lartpërmendur, vlerëson se bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në raport me rezultatet e tjera në tërësinë e procesit të rivlerësimit, pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale prej (-) 354.445 lekësh nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

81. Komisioneri Publik, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë *apartament banimi, me sipërfaqe 86 m², ndodhur në {***}, Tiranë*, përveç sa është konstatuar nga Komisioni për mungesën e burimeve të ligjshme për të kursyer dhe për të përballuar shpenzimet për vitet 2005 dhe 2008, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme kursimet, shpenzimet dhe pagesat e kryera edhe në vitin 2007. Sipas Komisionerit Publik shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhen përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së/INSTAT dhe jurisprudencës së Kolegjit, të cilat në total për familjen e subjektit, për vitin 2007, llogariten në vlerën prej 943.872 lekësh, çka afekton analizën financiare të vitit 2007, duke çuar në një mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 215.826 lekësh. Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se këto pamjaftueshmëri të konstatuara, lidhur me kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi i kësaj pasurie, nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por në tërësinë e vlerësimit të fakteve të konstatuara dhe të trajtuara në këtë ankim, duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 të këtij ligji.

82. Subjekti i rivlerësimit parashtron se ankimi i Komisionerit Publik për këtë pasuri është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe nuk duhet të merret në konsideratë nga Kolegji. Komisioneri Publik pretendon se balanca financiare e vitit 2007 afektohet me vlerën prej (-) 215.826 lekësh, pasi shpenzimet e jetesës duhet të llogariten me vlerën prej 943.972 lekësh. Subjekti parashtron se nuk e kupton se ku e ka bazuar gjetjen e kësaj vlere për shpenzime jetese Komisioneri, ndërkohë që në vitin 2006 shpenzimet për jetesë kanë qenë në vlerën 438.228 lekë. Sipas tij,

pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar, pasi Komisioni shpenzimet i ka llogaritur në shumën prej 546.480 lekësh dhe kjo shumë është sipas standardit të INSTAT-it dhe ILDKPKI-së.

83. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *pasurinë apartament, me sip. 86 m², ndodhur në {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Tiranë, krijuar me kontratë sipërmarrjeje datë 12.06.2007 + kontratë shitjeje nr. {***}, datë 31.08.2016, me vlerë prej 48.700 eurosh; burimi i krijimit: të ardhura familjare + të ardhurat nga shitja e apartamentit në {***}*.
84. Sipas akteve në fashikuj konstatohet se pagesa për blerjen e këtij apartamenti është ndarë në këste: në vitin 2007 me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes është paguar vlera prej 22.000 eurosh, sipas mandatit të pagesës së datës 12.06.2007 të Emporiki Bank Albania S.A; në vitin 2008 është paguar vlera prej 15.000 eurosh referuar kontratës së shitblerjes, sipas mandateve të pagesës së datës 06.06.2008, për vlerën prej 10.000 eurosh dhe të datës 01.09.2008 për vlerën prej 5.000 eurosh¹³ dhe në vitin 2016 është paguar vlera e mbetur prej 11.700 eurosh ose 1.605.000 lekë.
85. Komisioni në vendim, pasi ka analizuar secilin prej burimeve të deklaruara nga subjekti, ka konkluduar se për këtë pasuri, referuar balancave negative që i kanë rezultuar në analizën e viteve prej (-) 354.445 lekësh [(-) 212.256 lekë për vitin 2005 dhe (-) 142.189 lekë, për vitin 2008] dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, në raport me rezultatet e tjera në tërësinë e procesit të rivlerësimit, pamjaftueshmëria financiare nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
86. Komisioneri Publik, në ankim, parashtrohet se në analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2007, që ka rezultuar me diferencë pozitive¹⁴, duhet të konsiderohen shpenzimet e jetesës në vlerën prej 943.872 lekësh dhe jo në vlerën e konsideruar nga Komisioni prej 546.480 lekësh. Sipas këtij parashtrimi të Komisionerit, duke u shtuar shpenzimet e jetesës me vlerën prej 397.392 lekësh, analiza e vitit 2007 për subjektin e rivlerësimit do të rezultonte me një diferencë negative prej 215.826 lekësh.
87. Në verifikim të analizës financiare të kryer në Komision, trupi gjykues konstaton se Komisioni në analizën e vitit 2007 ka konsideruar shpenzimet e jetesës për familjen me 4 familjarë në vlerën prej 546.480 lekësh, sipas të dhënave të vitit pasardhës 2008. Në raportin e rezultateve hetimore, në Aneksin nr. 1, “Metodologjia e kryerjes së analizës financiare”, Komisioni ka

¹³ Referuar mandateve bashkëlidhur shkresës së ASHK-së, por sjellë dhe nga subjekti bashkë me deklaratën *vetting*.

¹⁴ Si rezultat i total të ardhurave prej 1.749.755 lekësh [të ardhura subjekti 1.330.655 lekë + bashkëshortja 393.481 lekë + interesat e depozitave 25.619 lekë], zbritur shpenzimet prej 583.480 lekësh [shpenzime jetese për 546.480 lekë + shpenzime arsimimi për fëmijët, Tiranë, konvikt prej 37.000 lekë], zbritur pagesa për apartamentin prej 22.000 euro ose 2.660.020 lekësh dhe zbritur pakësimin e likuiditeteve në cash dhe bankë prej 1.675.311 lekësh, rezulton diferenca pozitive prej (+) 181.566 lekësh.

sqaruar se shpenzimet e jetesës, për vitet 2003 – 2016 u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën e ILDKPKI-së¹⁵, sipas përbërjes familjare. Komisioni nuk ka dhënë shpjegime të mëtejshme lidhur me konsiderimin e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, njësoj sa ato të vitit pasardhës 2008 prej 546.480 lekësh.

88. Lidhur me shpenzimet e jetesës për vitin 2007, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik i ka përlllogaritur këto shpenzime në shumën 943.782 lekë, bazuar në të dhënat e përcjella nga ILDKPKI-ja në institucionet e rivlerësimit. Këto të dhëna të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve të jetesës të hartuar nga ILDKPKI-ja janë bazuar në standardet e raportuara nga institucioni i vetëm i specializuar për statistikat, INSTAT, dhe këto vlera janë përdorur nga ILDKPKI-ja nga viti 2004 e në vijim, në ushtrimin e funksioneve të saj kontrolluese ndaj subjekteve deklaruese, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Mënyra e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh, sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it për secilin vit të analizës financiare, përfshirë dhe vitin 2007, përbën një qëndrim të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit¹⁶, jo vetëm si nevojë për ta mbështetur vendimmarrjen në të dhëna të standardizuara, dokumente dhe prova të besueshme sipas parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por edhe në mbështetje të frymës që përshkon dispozitat kushtetuese dhe që reflektohet edhe në dispozitat e ligjit të sipërcituar se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore të specializuara, pasi është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të.
89. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në apelin kundërshtues se nuk kupton ku e ka gjetur Komisioneri Publik vlerën e shpenzimit të jetesës prej 943.972 lekësh për vitin 2007, trupi gjykues vëren se ky informacion është në shkresën me nr. {***} prot., datë 04.03.2019, që ILDKPKI-ja i ka dërguar Komisionit, shkresë e cila ndodhet në fashikujt e Komisionit, si dhe është referuar dhe në raportin e rezultateve hetimore në Aneksin nr. 1, “Metodologjia e kryerjes së analizës financiare”.
90. Sa më sipër, për sa ka paraqitur në ankim Komisioneri Publik, si dhe ka prapësuar në Kolegj subjekti i rivlerësimit referuar analizës së vitit 2007, trupi gjykues vlerëson se qëndron pretendimi i Komisionerit Publik për konsiderimin e shpenzimeve për këtë vit në vlerën prej 943.872 lekësh, të përlllogaritura sipas standardit të ILDKPKI-së. Për pasojë, analiza financiare e vitit 2007, në ndryshim nga analiza financiare e kryer në Komision, rezulton me një balancë negative dhe mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 215.826 lekësh.

¹⁵ Komisioni ka referuar në vendim, në poshtëshënim, se i është referuar shkresës, nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të ILDKPKI, e cila është e njëjta shkresë që është përcjellë nga ILDKPKI-ja dhe në Kolegj, me nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

¹⁶ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 18, datë 08.06.2022 dhe (JR) nr. 32, datë 24.07.2023.

91. Në konkluzion, lidhur me këtë gjetje të paraqitur në ankim nga Komisioneri Publik, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar konstatimi i Komisionerit që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme kursimet, shpenzimet dhe pagesat e kryera në vitin 2007, për pasurinë *apartament banimi me sipërfaqe 86 m²*, ndodhur në {***} Tiranë dhe, për rrjedhojë, gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
92. *Për pasurinë apartament 1+1, ndodhur në lagjen “{***}”, Berat*, Komisioneri Publik, në kushtet kur: (i) deklarimi në deklaratën *vetting* për këtë pasuri në përdorim konstatohet i mangët; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë banuar në këtë apartament për rreth 10 vite; (iii) aktet e administruara lidhur me këtë pasuri janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, pas konstatimeve të Komisionit; dhe (iv) këto akte paraqesin të dhëna kontradiktore ndërmjet tyre, lidhur me të drejtat reale të pronësisë/posedimit, vlerëson se janë kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar këtë pasuri dhe këto rrethana të padeklaruara nga subjekti dhe në deklaratën *vetting*, e duhen analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
93. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në Kolegj se ky shkak ankimi i Komisionerit Publik është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe nuk duhet të merret në konsideratë nga Kolegji, pasi në deklaratat periodike është deklaruar prej tij shumë qartë adresa e banimit, si dhe marrëdhënia me këtë apartament, ndërsa në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar për shkak se nuk ka qenë e formalizuar kontrata e qirasë. Pagesa e energjisë elektrike, për shkak se nuk ka pasur kontratë qiraje, është bërë me librezën që ka qenë në emër të shtetasit G. C., i cili ka pasur një kontratë të mëparshme me pronarin e apartamentit në fjalë. Subjekti i rivlerësimit, bashkë me aktin apel kundërshtues të paraqitur në Kolegj, ka sjellë dhe disa akte si dokumente justifikuese për sqarimet e dhëna prej tij.
94. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se:
- 94.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vendqëndrim/adresë tjetër banimi në lagjen “{***}”, Berat. Po këtë adresë, si adresë të dytë, ka dhënë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore 2011-2016.
- 94.2. Gjatë hetimit në Komision, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar në apartamentin në lagjen “{***}”, Berat, prej muajit shtator 2012 e vijim dhe deri në datën 31.12.2017 nuk ka pasur kontratë qiraje të formalizuar e më pas në datën 15.01.2018 ka lidhur kontratë qiraje me shoqërinë “{***}” ShPK (të cilën ia ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit)¹⁷. Po në këtë pyetësor, në pyetjen 6, subjekti ka deklaruar se *gjatë*

¹⁷ Përgjigje e pyetjes 1: Në shtator 2012 kam tërhequr familjen nga Skrapari në Berat, ku kam banuar në një apartament 1+1, të ndodhur në lagjen “{***}”, me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 78.7 m² (sip. totale), {***}, pronar i të cilës është shoqëria “{***}” ShPK, me përfaqësues ligjor D. P.. Nga shtator 2012 deri më 31.12.2017 nuk kam pasur kontratë qiraje të formalizuar midis meje dhe kësaj shoqërie, por ka qenë kontratë verbale në vlerën 5.000 (pesëmijë) lekë në muaj.

periudhës së deklarimit kam në përdorim (kontratë qiraje verbale dhe kontratë qiraje e formalizuar) apartamentin 1+1 të sipërcituar te përgjigja e pyetjes së parë.

94.3. Në pyetësonin nr. 2, datë 07.04.2022, subjekti në vijim të pyetjes së Komisionit ka deklaruar se nuk ka gjykuar çështje civile, penale, familjare apo administrative ndaj shoqërisë “{***}” ShPK (shoqëria qiradhënëse), duke bashkëlidhur dhe shkresën nr. {***} prot., datë 13.04.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, që vërteton deklarimin e tij.

94.4. Në pyetësonin nr. 5, subjekti ka deklaruar *se prej muajit qershor 2021 e në vazhdim banoj me qira tek apartamenti i shtetasve H. Ç. dhe A. Ç., me adresë lagja “{***}” Berat, pasuria nr. {***}, {***}, shkalla {***}, apartamenti {***}, me kontratë verbale me shtetasin E. Ç. (vëllai i shtetasit H. Ç.). Në apartamentin me nr. {***}, me pronar “{***}” ShPK D. P. kam banuar me qira deri në muajin maj 2021. Kontrata e qirasë me përfaqësuesin e “{***}” ShPK D. P. është zgjidhur me mirëkuptim në datën 15.06.2021. Bashkëlidhur këtij pyetësoni subjekti ka sjellë aktet: vërtetimi i “{***}” ShPK, datë 15.06.2021; librezja e energjisë elektrike me nr. kontrate {***}; formulari i mbylljes së kontratës së ujit datë 15.06.2021; mandatarkëtimi datë 15.06.2021.*

95. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të ankimit të Komisionerit Publik, ka sjellë disa akte¹⁸, të cilat u administruan nga trupi gjykues i Kolegjit në cilësinë e provës, me qëllim për të vërtetuar marrëdhënien e pronësisë, si dhe marrëdhënien e mëparshme me apartamentin të shtetasit G. C., në emër të të cilit ka qenë librezja e energjisë elektrike. Sipas dy akteve noteriale, deklaratës noteriale nr. {***}, datë 08.08.2012, midis G. C. dhe D. P., për anulimin e shitjes së apartamentit dhe kontratës së shitblerjes, datë 23.01.2022, nga “{***}” ShPK, tek E. G., rezulton se pronar i apartamentit, gjatë periudhës që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar në të, ka qenë shoqëria “{***}” ShPK.

96. Trupi gjykues vëren se në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting* provohet nga aktet e cituara më sipër se subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim apartamentin në fjalë dhe ka deklaruar vetëm adresën, por jo përdorimin e tij. Trupi gjykues vëren se pavarësisht pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në deklaratat periodike vjetore e ka deklaruar adresën e këtij apartamenti, në këto deklarata nuk ka asnjë të dhënë tjetër për përdorimin e apartamentit në fjalë.

¹⁸ *Bashkëlidhur me apelin kundërshtues, subjekti ka paraqitur aktet: (i) kopje e librezës së energjisë elektrike në emër të G. C.; (ii) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 08.08.2012, midis G. C. dhe D. P. për anulimin e shitjes së apartamentit, në të cilën palët deklarojnë se G. C. ka blerë një apartament prej 47.000 eurosh dhe palët me mirëkuptim e kanë anuluar shitjen; (iii) formular i kërkesës së aplikantit D. P., datë 21.06.2021, të OSShE-së, për ndryshim emri nga G. C. në “{***}” ShPK; (iv) faturë tatimore/kopje elektronike, datë 30.05.2021, të FShU, OSShE Group në emër të G. C.; (v) faturë tatimore/kopje elektronike, datë 29.06.2021, të FShU, OSShE Group në emër të “{***}” ShPK; (vi) kontratë shitblerje, datë 23.01.2022, nga “{***}” ShPK tek E. G. dhe Kartela e Pasurisë së Paluajtshme elektronike e ASHK/DV Berat, datë 28.01.2022, në emër të E. G. dhe A. B. C.*

97. Trupi gjykues vlerëson se lidhur me situatën faktike të përdorimit të apartamentit prej subjektit të rivlerësimit të rezultuar gjatë hetimit në Komision, ai kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën *vetting*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, ku parashikohet se: *Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij apartamenti si një pasuri në përdorim të tij. Ekzistenca e një marrëdhënieje përdorimi nga ana e subjektit dhe mosdeklarimi prej tij në kuadër të procesit të rivlerësimit me argumentin jobindës se ka qenë një marrëdhënie jo e formalizuar, e ka bërë të pamundur verifikimin e situatës reale të kësaj pasurie në raport me pretendimet e subjektit.*
98. Sa më sipër, për sa i përket apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}” Berat, të cilin subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim për një periudhë 10-vjeçare, trupi gjykues konstaton se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*, për përdorimin e kësaj pasurie duke u gjendur në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, e duke sjellë pamundësinë objektive për të kontrolluar këtë pasuri në procesin e rivlerësimit.
99. Në konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pamjaftueshmëria e konstatuar e mbulimit me burime të ligjshme e kursimeve, shpenzimeve dhe pagesat e kryera në vitin 2007, së bashku me pamjaftueshmëritë për vitet 2005 dhe 2008 të konkluduara nga Komisioni, si dhe pasaktësitë në deklaramet në deklaratën *vetting*, për zotërimin e aksioneve të “{***}” ShA dhe përdorimin e apartamentit në Berat, edhe pse nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, janë konsideruar nga Kolegji në vlerësimin tërësor, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
100. Mangësitë që rezultuan në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të konstatuara prej vlerësimit të çështjeve penale dhe denoncimeve nga publiku, së bashku me problematikat e konkluduara më sipër në vlerësimin e kriterit të pasurisë, çuan Kolegjin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
101. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, në zbatim të neneve D e E të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2 e 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi nr. 574, datë 18.10.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.12.2023, në Tiranë.

ANËTARE	ANËTARE	ANËTAR
Albana SHTYLLA	Rezarta SCHUETZ	Sokol ÇOMO
<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>
RELATORE	KRYESUESE	
Mimoza TASI	Natasha MULAJ	
<i>nënshkrimi</i>	<i>nënshkrimi</i>	